



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

P.2024:148184

NE EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ Dega në Kaçanik, Gjyqtari Burim Çaka, në lëndën penale kundër të pandehurit Sh.L, i akuzuar për veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore - Ferizaj PP/II.nr.581/24 të datës 22.05.2024, lidhur me kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor, më datë 29.05.2024 merr këtë:

AKTGJYKIM

PRANOHET propozimi Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.581/24 të datës 22.05.2024, gjykata lëshon këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri: Sh.L nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut Rr."...", i lindur më datë ..., nga i ati A...dhe e ëma H... e gjinisë L..., me numër personal..., i martuar, prind i 2 fëmijëve, i pa punë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 04.04.2024, rreth orës 12.30, në Rajonin Ekonomiko Pyjor Gilloboqicë, në vendin e quajtur "Tumet e Epra", me qëllim vjedhje, ka prerë me sharrë motorike 57 copë trungje, të llojit bungu dhe qarri të njomë, me diametër 10 – 15 cm, të gjata me bonitet 4, në vëllim të përgjithshëm prej 2.39 m³, ku për bartje kishte një kalë me samar, me të cilin veprim ka dëmtuar APK – zyra në Kaçanik, në vlerë prej 310.50 €

- Me të cilin veprim ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 2, 17, 38, 40, 81, 82, 69, 70, 71, dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 364 dhe 453 të KPPK-së, e gjykon me:

VËREJTJE GJYQËSORE

I. Të pandehurit i bëhet me dije se ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën vepër penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do të i shqiptojë një sanksion më të rëndë penal.

II. Obligohet i pandehuri që palës së dëmtuar t'ia paguaj dëmin në vlerë 310.50 €

III. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën 20.00€, si dhe për Fondin për Kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën 20.00€, të gjitha këto shuma t'i paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj me Aktakuzën PP/II.nr.581/24 të datës 22.05.2024 ka akuzuar të pandehurin Sh.L për veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe i ka propozuar që pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor të lëshohet urdhëri ndëshkimor, sipas të cilit të pandehurit t'i shqiptohet vërejtje gjyqësore.

Duke u bazuar në aktakuzën e Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.581/24 të datës 22.05.2024, dhe provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, gjykata konstaton se i pandehuri në mënyrë, vend, kohë ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi dhe se në veprimet e të pandehurit arrihen të gjitha elementet e veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata e shqyrtoi Aktakuzën dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor dhe gjeti se Aktakuza dhe kërkesa janë të bazuar në bazë të nenit 495 të KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-ës, që të merr vendim për urdhër ndëshkimor si në dispozitiv, pasi që nga shkresat e lëndës vërtetohet se ka prova të mjaftueshme, të cilat vërtetojnë fajësinë e të pandehurit se ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë sipas Aktakuzës së Prokurorisë së Shtetit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë provat të cilat janë të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit, se ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, sipas aktakuzës së prokurorisë, kjo vërtetohet edhe nga prova si: Fletëparaqitja e rojës së pyllit me numër të ditarit 02/2024, e datës 04.04.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit Shefit Kuçi, në Prokurorin Themelore në Ferizaj, i datës 17.05.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit Nazim Kuçi, në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i datës 17.05.2024, - Procesverbali për marrjen e deklaratës së të pandehurit Sh.L, në Prokurorin Themelore në Ferizaj, me datën 17.05.2024, Fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë veprimet në kuptim të veprës penale me të cilën akuzohet i pandehuri.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenet 69, 70 të KPRK-së ka marrë për bazë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në këtë aspekt si rrethana lehtësuese gjeti se nuk ka të dhëna se i pandehuri është recidivist. Ndërsa si rrethanë rënduese nuk gjeti përpos veprimeve të cilat plotësojnë figurën e veprës penale.

Sipas bindjes së Gjykatës dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit, duke i marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe vlerëson se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve të paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorëve të saj, që do të shërbejë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPRK-ës, gjykata ka vendosur që ta obligoj të pandehurin që palës së dëmtuar të ia paguaj dëmin në vlerë prej 310.50€, duke u bazuar në kërkesën pasurore juridike të palës së dëmtuar, të cilën vlerë e ka përcaktuar komisioni i ekspertëve për vlerësimin dhe konstatimin e dëmit

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj duke u bazuar në të gjitha të cekurat më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA NË KAÇANIK

P.2024:148184 të dates 29.05.2024

Gjyqtari:

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi - urdhëri ndëshkimor, mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimet të aktgjykimit. Kundërshtimi i drejtohet Gjykatës Themelore Ferizaj dega në Kaçanik.